



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 153**

**27 nëntor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 105/2012 datë 8.11.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)..... 8311
Ligj nr. 106/2012 datë 8.11.2012	Për ratifikimin e instrumentit të angazhimit të Republikës së Shqipërisë në shtesën e burimeve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), plotësimi i gjashtëmbëdhjetë..... 8315
Vendim i KM nr. 776, datë 15.11.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 670, datë 3.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e ekspozimit, në Romë, Itali, të disa objekteve të rralla me vlera unike, në kuadër të realizimit të ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri më 6 janar 2013”..... 8323
Vendim i KM nr. 777, datë 16.11.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 693, datë 10.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania dhe Intesa Sanpaolo sh.a., Albania, në kuadër të kontratave përkatëse ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a..... 8323
Vendim i KM nr. 779, datë 14.11.2012	Për lejimin e Inspektoratit Qendror, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratës, me objekt “Rikonstruksion i ambienteve në përdorim” ..... 8324
Vendim i KM nr. 793, datë 14.11.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, si autoritet kontraktor..... 8324
Vendim i KM nr. 794, datë 14.11.2012	Për lejimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit ..... 8325
Vendim i KM nr. 795, datë 14.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Financave..... 8326

Vendim i KM nr. 798, datë 14.11.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 713, datë 16.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar, Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizmin e dramës fituese, shpallur në konkursin me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë” .....	8326
Vendim i KM nr. 799, datë 14.11.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për disa institucione, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritete kontraktore.....	8327
Udhëzim i MF dhe RTSH nr. 24, datë 2.11.2012	Për një shtesë e ndryshim në udhëzimin nr. 1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, të ndryshuar.....	8329
Urdhër i MB nr. 244/1, datë 15.11.2012	Për delegim kompetencash .....	8330
Vendim i ERE nr. 151, datë 12.11.2012	Për fillimin e procedurës për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.....	8330
Vendim i ERE nr. 152, datë 12.11.2012	Për rishikimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008.....	8331
Vendim i ERE nr. 153, datë 12.11.2012	Për modifikimin e licencës me nr. 13, seria PV03K, të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Barmash”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, modifikuar me vendimin nr. 79, datë 23.10.2009.....	8332
Vendim i ERE nr. 154, datë 12.11.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	8333
Vendim i ERE nr. 155, datë 12.11.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	8334
Vendim i ERE nr. 156, datë 12.11.2012	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë...	8335
Vendim i ERE nr. 157, datë 15.11.2012	Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit për muajin dhjetor 2012.....	8336
Vendim i ERE nr. 158, datë 16.11.2012	Për fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar..	8337

**LIGJ**  
**Nr. 105/2012**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NDRYSHIMET E NENEVE TË  
MARRËVESHJES SË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në lidhje me reformën e bordit ekzekutiv, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Republika e Shqipërisë pranon rritjen e kuotave të anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas rezolutës nr. 66-2, datë 15 dhjetor 2010, të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

**Neni 3**

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rregullat dhe autoritetin kompetent për realizimin e shtesës së kuotave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7822, datë 19.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



## SHTOJCA I

### NDRYSHIMI I PROPOZUAR I NENEVE TË MARRËVESHJES SË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR PËR REFORMËN E BORDIT EKZEKUTIV

Qeveritë, në emër të të cilave nënshkruhet kjo marrëveshje, bien dakord si më poshtë:

1. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (b) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“b) Në pajtim me pikën (c), më poshtë, bordi ekzekutiv përbëhet nga njëzet drejtorë ekzekutivë të zgjedhur nga anëtarët, me drejtorin menaxher si kryetar.”.

2. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (c) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“c) Për qëllimin e çdo zgjedhjeje të rregullt të drejtorëve ekzekutivë, Bordi i Guvernatorëve, nëpërmjet një shumice prej tetëdhjetë e pesë për qind të fuqisë votuese të përgjithshme, mund të shtojë ose të pakësojë numrin e drejtorëve ekzekutivë të specifikuar te (b) më sipër.”.

3. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (d) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“d) Zgjedhjet e drejtorëve të përgjithshëm mbahen në intervale prej dy vjetësh, në pajtim me rregulloret që miratohen nga Bordi i Guvernatorëve. Këto rregullore përfshijnë një kufi të numrit të përgjithshëm të votave që mund të hedhë më shumë se një anëtar për të njëjtin kandidat.”.

4. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (f) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“f) Drejtorët ekzekutivë mbeten në detyrë deri në zgjedhjen e pasuesve të tyre. Nëse posti i një drejtori ekzekutiv mbetet vakant më shumë se nëntëdhjetë ditë para përfundimit të mandatit, zgjidhet një drejtor tjetër ekzekutiv për pjesën e mbetur të mandatit nga anëtarët që kanë zgjidhur drejtorin e mëparshëm ekzekutiv. Për zgjedhjen kërkohet një shumicë e votave të hedhura. Ndërsa posti mbetet vakant, zëvendësi i drejtorit ekzekutiv të mëparshëm ushtron kompetencat e tij, përveç atij që emëron zëvendësin.”.

5. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (i) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“i) i) çdo drejtor ekzekutiv ka të drejtë të hedhë numrin e votave që janë hedhur për zgjedhjen e tij;

ii) nëse zbatohen dispozitat e seksionit 5 (b), votat që një drejtor ekzekutiv do të kishte të drejtë të hidhte, shtohen ose pakësohen përkatësisht. Të gjitha votat që ka të drejtë të hedhë një drejtor i përgjithshëm hidhen si një e tërë;

iii) nëse pezullimi i të drejtave të votimit të një anëtari ndërpritet sipas nenit XXVI, seksioni 2 (b), anëtari mund të bjerë dakord me të gjithë anëtarët që janë zgjedhur një drejtor ekzekutiv që numri i votave të caktuara atij anëtari të hidhen nga ky drejtor ekzekutiv, me kusht që nëse nuk është bërë një zgjedhje e rregullt e drejtorit ekzekutiv gjatë periudhës së pezullimit, drejtori ekzekutiv në zgjedhjen e të cilit ka marrë pjesë anëtari para pezullimit, ose pasuesi i tij i zgjedhur në pajtim me paragrafin 3 (c) (i) të grafikut L ose me (f) më sipër, të ketë të drejtë të hedhë numrin e votave të caktuara anëtarit. Anëtari konsiderohet të ketë marrë pjesë në zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv me të drejtën e hedhjes së numrit të votave të caktuara anëtarit.”.

6. Teksti i nenit XII, seksioni 3 (j) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“j) Bordi i Guvernatorëve miraton rregulloret, sipas të cilave një anëtar mund të dërgojë një përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e bordit ekzekutiv, nëse shqyrtohet një kërkesë e bërë prej tij ose që ndikon në masë të konsiderueshme tek ai anëtar.”.

7. Teksti i nenit XII, seksioni 8 ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Fondi ka gjithmonë të drejtë të komunikojë mendimet e veta në mënyrë joformale te çdo anëtar për çdo çështje që lind në bazë të kësaj marrëveshjeje. Fondi, me një shumicë prej shtatëdhjetë për qind të të gjithë fuqisë votuese, mund të vendosë të publikojë një raport të bërë një anëtar në lidhje me kushtet dhe zhvillimet e tij monetare dhe ekonomike që synojnë drejtpërdrejt të shkaktojnë çekuilibër në balancën ndërkombëtare të pagesave të anëtarëve. Anëtari përkatës ka të drejtën e përfaqësimit në pajtim me seksionin 3 (j) të këtij neni. Fondi nuk publikon një raport që përfshin ndryshimet në strukturën themelore të organizimit ekonomik të anëtarëve.”.

8. Teksti i nenit XXI (a) (ii) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“a) ii) Për vendimet e bordit ekzekutiv për çështjet që i përkasin përjashtimisht Departamentit të Drejtave të Veçanta të Tërheqjes, kanë të drejtë të votojnë vetëm drejtorët ekzekutivë të zgjedhur me të paktën një anëtar që është pjesëmarrës. Secili prej këtyre drejtorëve ekzekutivë ka të drejtë të hedhë numrin e votave të caktuar anëtarëve që janë pjesëmarrës, votat e të cilëve kanë bërë zgjedhjen e tij. Vetëm prania e drejtorëve ekzekutivë të zgjedhur nga anëtarët që janë pjesëmarrës dhe votat e caktuar anëtarëve që janë pjesëmarrës llogariten për qëllimin e përcaktimit nëse ekziston kuorumi ose nëse një vendim merret nga shumica e kërkuar.”.

9. Teksti i nenit XXIX (a) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“a) Çdo çështje interpretimi e dispozitave të kësaj marrëveshjeje që lind ndërmjet një anëtari dhe fondit ose ndërmjet anëtarëve të fondit i paraqitet bordit ekzekutiv për vendim. Nëse çështja cenon në mënyrë të veçantë një anëtar, ai ka të drejtën e përfaqësimit në pajtim me nenin XII, seksioni 3 (j).”.

10. Teksti i paragrafit 1 (a) i grafikut D ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“a) Çdo anëtar ose grup anëtarësh që ka numrin e votave të caktuara të tij ose të atyre të dhëna nga një drejtor ekzekutiv emëron në Këshill një këshilltar, i cili është guvernator, ministër në qeverinë e një anëtari ose person i nivelit të krahasueshëm dhe mund të emërojë jo më shumë se shtatë përfaqësues. Bordi i Guvernatorëve, me tetëdhjetë e pesë për qind të shumicës së votave të të gjithë fuqisë votuese, mund të ndryshojë numrin e përfaqësuesve që mund të emërohen. Një këshilltar ose përfaqësues qëndron në detyrë derisa të bëhet një emërim i ri ose deri në zgjedhjen e radhës së drejtorëve ekzekutivë, cilado të jetë e para.”.

11. Teksti i paragrafit 5 (e) i grafikut D shfuqizohet.

12. Paragrafi 5 (f) i grafikut D rinumërohet 5 (c) i grafikut D dhe teksti i paragrafit të ri 5 (e) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“e) Nëse një drejtor ekzekutiv ka të drejtë të hedhë numrin e votave të caktuara një anëtari në pajtim me nenin XII, seksioni 3 (i) (iii), këshilltari i emëruar nga grupi, anëtarët e të cilit kanë zgjedhur drejtorin ekzekutiv, ka të drejtë të votojë dhe të hedhë numrin e votave të caktuara atij anëtari. Anëtari konsiderohet të ketë marrë pjesë në emërimin e këshilltarit me të drejtë vote dhe për hedhjen e numrit të votave të caktuara anëtarit.”.

13. Teksti i grafikut E ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Dispozita të përkohshme në lidhje me drejtorët ekzekutivë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij grafiku:

a) Çdo drejtor ekzekutiv, i cili është emëruar në pajtim me nenin e mëparshëm XII, seksionet 3 (b) (i) ose 3 (c) dhe ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij grafiku, konsiderohet të jetë zgjedhur nga anëtari i cili e ka emëruar atë; dhe

b) Çdo drejtor ekzekutiv, i cili ka hedhur numrin e votave të një anëtari në pajtim me nenin e mëparshëm XII, seksioni 3 (i) (ii) dhe ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij grafiku, konsiderohet të jetë zgjedhur nga ky anëtar.”.

14. Teksti i paragrafit 1 (b) i grafikut L ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“b) emëron një guvernator ose zëvendësguvernator, emëron ose merr pjesë në emërimin e një këshilltari ose zëvendëskëshilltari, ose zgjedh apo merr pjesë në zgjedhjen e një drejtori ekzekutiv.”.

15. Teksti i fillimit të paragrafit 3 (c) i grafikut L ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“c) Drejtori ekzekutiv i emëruar nga anëtari apo në zgjedhjen e të cilit ka marrë pjesë anëtari, pushon së qeni në detyrë, përveç kur ky drejtor ekzekutiv ka pasur të drejtë të hedhë numrin e votave të caktuara anëtarëve të tjerë të drejtat votuese të të cilëve nuk janë pezulluar. Në rastin e fundit.”.



**SHTOJCA II  
ANEKSI I**

**Deklaratë e pranimit<sup>1</sup>**  
(Për t'iu drejtuar Sekretarit të Fondit)

**DEKLARATË PRANIMI E NDRYSHIMIT TË PROPOZUAR PËR REFORMËN E BORDIT  
EKZEKUTIV**

1. Kam nderin t'ju informoj se (anëtari) pranon ndryshimin e propozuar të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për Reformën e Bordit Ekzekutiv.

(2. Një kopje e ligjit/dekretit/rregullores në pajtim me të cilën bëhet ky pranim, ndodhet bashkëlidhur).

**SHTOJCA II  
ANEKSI II**

**Njoftim i pranimit<sup>2</sup>**  
(Për t'iu drejtuar Sekretarit të Fondit)

**NJOFTIM PRANIMI I NDRYSHIMIT TË PROPOZUAR PËR REFORMËN E BORDIT  
EKZEKUTIV**

1. Kam nderin t'ju informoj se (anëtari) pranon ndryshimin e propozuar të neneve të të marrëveshjes së fondit monetar ndërkombëtar për reformën e bordit ekzekutiv.

(2. Një kopje e ligjit/dekretit/rregullores në pajtim me të cilën bëhet ky pranim, ndodhet bashkëlidhur.)

---

<sup>1</sup> Për përdorimin e këtyre formularëve dhe përfshirjen ose mospërfshirjen e paragrafit 2, shihni shënimin më sipër, paragrafi 4 (c) dhe 5.

<sup>2</sup> Për përdorimin e këtyre formularëve dhe përfshirjen ose mospërfshirjen e paragrafit 2 ose teksti në kllapa katrore brenda paragrafit 2, shihni shënimin më sipër, paragrafi 4 (c) dhe 5.

**LIGJ**  
**Nr. 106/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E INSTRUMENTIT TË ANGAZHIMIT TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË SHITESËN E BURIMEVE TË SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR  
ZHVILLIM (IDA), PLOTËSIMI I GJASHTËMBËDHJETË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet instrumenti i angazhimit të Republikës së Shqipërisë në shtesën e burimeve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), plotësimi i gjashtëmbëdhjetë.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7823, datë 19.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

Banka Botërore  
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim  
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

1818 h Street N.W.  
Washington D.C.20433  
USA

(202) 473-1000  
Adresa kabllore: INTBAFRAD  
Adresa kabllore: INDEVAS

**(PËR GUVERNATORËT, ZËVENDËSIT DHE SHTETET ANËTARE)**

9 maj 2011

Shtesat e burimeve të IDA-s - Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë

I nderuar anëtar,

Në referencë të letrës sime të datës 22 mars 2011, me një projektrezolutë të titulluar “Shtesat e burimeve: Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë”, dëshiroj t’ju informoj se rezoluta u miratua nga Bordi i Guvernatorëve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), më 26 prill 2011 (rezoluta nr. 227) dhe ndodhet bashkëlidhur për referencën tuaj.

Sipas paragrafit 2 të rezolutës nr. 227, shteteve anëtare u kërkohet të depozitojnë pranë IDA-s një instrument angazhimi në formë të bashkëlidhur, për të konfirmuar pjesëmarrjen në plotësimin e gjashtëmbëdhjetë. Do t’ju isha mirënjohës nëse do të merrnit masa në lidhje me përmbushjen e instrumentit të angazhimit nga një përfaqësues i autorizuar i qeverisë suaj dhe nëse do të ma ktheni këtë dokument brenda një kohe sa më të shpejtë.



Duke marrë parasysh se periudha e angazhimit të plotësimit të gjashtëmbëdhjetë fillon më 1 korrik 2011, marrja paraprake e instrumentit tuaj të angazhimit nga IDA do të garantojë më tej që plotësimi të hyjë në fuqi brenda një date sa më të afërt.

Duke ju falënderuar për ndihmën dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme ndaj IDA-s,

Me respekt,  
Jonge Familiar  
Zëvendës-president dhe Sekretar Korporativ

Shtojca  
Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë  
Shqipëri

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM  
Shtesat e burimeve: Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë

#### Instrumenti i angazhimit

Duke iu referuar rezolutës nr. 227 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, me titull “Shtesat e burimeve: Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë”, e cila u miratua më 26 prill 2011 (rezoluta).

Me anë të këtij Instrumenti, Qeveria e Republikës së Shqipërisë njofton Shoqatën sipas paragrafit 2 të rezolutës se do të autorizojë nënshkrimin për të në përputhje me kushtet e rezolutës, në shumën prej 1,205,016 lekësh<sup>3</sup>.

4

\_\_\_\_\_  
(Data)

\_\_\_\_\_  
(Emri dhe pozicioni)

<sup>3</sup> Sipas paragrafit 5 (a) të rezolutës së plotësimit të gjashtëmbëdhjetë, anëtarëve u kërkohet të klasifikojnë nënshkrimin dhe kontributin e tyre ose vetëm nënshkrimin, sipas rastit, në SDR, në monedhën e anëtarit, nëse është lirisht e konvertueshme, ose me marrëveshjen e asociimit, në një monedhë lirisht të konvertueshme të anëtarit tjetër. Pagesa do të kryhet, siç parashikohet në paragrafin 5 (b) të rezolutës.

<sup>4</sup> Instrumenti duhet të nënshkruhet në emër të qeverisë nga një përfaqësues i autorizuar sipas rregullave.



IDA, SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM, BORDI I GUVERNATORËVE  
REZOLUTA NR. 227 SHITESAT E BURIMEVE: PLOTËSIMI I GJASHTËMBËDHJETË  
APROVUAR NGA BORDI I GUVERNATORËVE TË IDA-S, MË 26 PRILL 2011

Duke marrë në konsideratë se:

A) Drejtorët ekzekutivë të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata) kanë shqyrtuar kërkesat e mundshme financiare të Shoqatës dhe kanë arritur në përfundimin se preferohet autorizimi i një plotësimi të burimeve të Shoqatës për angazhimet e reja të financimit për periudhën nga data 1 korrik 2011 deri në 30 qershor 2014 “Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë”, në shumat dhe mbi bazën e përcaktuar në raportin e përfaqësuesve të IDA-s “Shtesat e burimeve: Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë” (Raporti), të aprovuar nga drejtorët ekzekutivë, më 15 shkurt 2011 (ndryshuar më 18 mars 2011) dhe të paraqitur Bordit të Guvernatorëve;

B) Anëtarët e Shoqatës çmojnë se kërkohet një rritje e burimeve të Shoqatës dhe synojnë të marrin të gjitha masat e nevojshme qeveritare dhe legjislative për të autorizuar dhe aprovuar alokimin e burimeve shtesë për Shoqatën në shumat dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë rezolutë;

C) Anëtarët e Shoqatës që kontribuojnë me burime për Shoqatën, përveç nënshkrimeve të tyre si pjesë e plotësimit të gjashtëmbëdhjetë (anëtarët kontribues), duhet të vënë në dispozicion kontributin e tyre në formën e nënshkrimeve që përfshijnë të drejtat e votimit dhe pjesërisht si burime plotësuese në formën e kontributeve që nuk përfshijnë të drejta votimi;

D) Nënshkrime shtesë duhet të autorizohen për shtetet kontribuuese në këtë rezolutë dhe mbi bazën e marrëveshjes së tyre në lidhje me të drejtat e parablerjes sipas nenit III, seksioni 1 (c) të neneve dhe masa merren për anëtarët e tjerë të Shoqatës “Anëtarët nënshkrues”, të cilët synojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre për ta bërë këtë sipas asaj dispozite;

E) Është e preferueshme të parashikohet që një pjesë e burimeve të cilat do të kontribuohen nga anëtarët, t’i paguhet Shoqatës si kontribut paradhënie;

F) Nënshkrime dhe kontribute shtesë duhet të autorizohen për anëtarët kontribues, mbi dhënien e kompensimit për zotimet e faljes së borxhit të Shoqatës sipas Iniciativës së borxhit për vendet e varfra me borxhe të mëdha (HIPC); për dhënien e financimit për operacionet e shlyerjes së borxheve të prapambetura nga Shoqata, për dhënien e kompensimit për riqarkullimet e mëparshme të principalit nga realizimi i grandeve, dhe për ofrimin e financimit për iniciativën e reagimit ndaj krizës;

G) Është e dëshirueshme të autorizohet Shoqata për të dhënë financim në formën e grandeve, garancive dhe ndërmjetësimin e produkteve për menaxhimin e riskut përveç huave; dhe

H) Është e dëshirueshme të administrohet çdo fond i mbetur nga rimbushja e autorizuar nga rezoluta nr. 219 e Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës (rimbushja e pesëmbëdhjetë), si pjesë e rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë.

Kështu Bordi i Guvernatorëve pranon raportin si të aprovuar nga drejtorët ekzekutivë, miraton përfundimet dhe rekomandimet e tij dhe vendos që të autorizohet një rritje e përgjithshme në abonimet e Shoqatës me termat dhe kushtet e mëposhtme:

1. Autorizimi i abonimeve dhe kontributeve

a) Shoqata autorizohet të pranojë burime shtesë nga secili anëtar kontribues në shumat e specifikuar për çdo anëtar në kolonat (2) (3) (7) dhe (10) të tabelës 1 bashkëngjitur kësaj rezolute dhe çdo shumë e tillë do të ndahet në një abonim që ka të drejta vote dhe një kontribut që nuk ka të drejta vote sipas specifikimit në tabelën 2 të bashkëngjitur kësaj rezolute:

i) si pjesë e burimeve të përshkuara në paragrafin 1(a) më sipër, Shoqata autorizohet të pranojë abonime dhe kontribute shtesë nga anëtarët kontribues për të kompensuar Shoqatën për



detyrimet e faljes së borxhit të Shoqatës sipas Inicativës së Borxhit HIPC në shumat sipas specifíkimit në kolonën (7) të tabelës 1 bashkëngjitur kësaj rezolute;

ii) si pjesë e burimeve të përshkruara në paragrafin 1(a) më sipër, Shoqata autorizohet të pranojë abonime dhe kontribute shtesë nga anëtarët kontribues për të financuar operacionet e shlyerjes së vonesave në shumat sipas specifíkimeve të kolonës (10) të tabelës 1 bashkëngjitur kësaj rezolute;

iii) si pjesë e burimeve të përshkruara në paragrafin 1(a) më sipër, Shoqata autorizohet të pranojë abonime dhe kontribute shtesë nga anëtarët kontribues për të financuar zbritjet nga shuma principale të parashikuara për shkak të dhënies së grandeve në shumat sipas specifíkimeve të kolonës (12) të tabelës 1 bashkëngjitur kësaj rezolute.

b) Shoqata autorizohet të pranojë burime shtesë nga çdo anëtar, për të cilin specifíkohen kontributet në tabelën 2 dhe abonimet, dhe kontributet shtesë nga anëtarët kontribues që u shtohen shumave të specifíkuara për secilin anëtar të tillë në tabelën 1;

c) Shoqata autorizohet të pranojë abonime shtesë nga secili anëtar abonent në shumën e specifíkuar për secilin anëtar të tillë në tabelën 2;

d) Të drejtat dhe detyrimet e Shoqatës dhe anëtarëve kontribues në lidhje me nënshkrimet dhe kontributet e autorizuara në paragrafët (a) dhe (b) më lart, do të jenë të njëjta (përveç kur parashikohet ndryshe në këtë rezolutë), si ato të zbatueshme për pjesën nëntëdhjetë për qind të nënshkrimeve fillestare të anëtarëve fillestarë, të pagueshme sipas nenit II, seksioni 2 (d) të neneve të marrëveshjes (nenet) nga anëtarët e renditur në pjesën I të skedulit A të neneve.

## 2. Marrëveshja për të paguar

a) Kur një anëtar kontribues bie dakord të paguajë nënshkrimin dhe kontributin e tij ose kur një anëtar nënshkrues bie dakord të paguajë nënshkrimin e tij, ai do të depozitojë pranë Shoqatës një instrument angazhimi, kryesisht në formën e përcaktuar në shtojcën I të kësaj rezolute (instrumenti i angazhimit) dhe në lidhje me kontributin e tij për faljen e borxhit sipas Inicativës së borxhit HIPC ose për operacione mbi shlyerjen e borxheve të prapambetura, një anëtar kontribues ose do të përfshijë këtë kontribut në një instrument angazhimi ose do të japë një kontribut transferimi për lehtësimin e borxhit, siç përcaktohet dhe specifíkohet në paragrafin 9 (a) të kësaj rezolute;

b) Kur një anëtar kontribues bie dakord të paguajë një pjesë të nënshkrimit dhe të kontributit të tij pa cilësim dhe pjesa e mbetur i nënshtrohet aprovimit nga legjislatura e tij e legjislacionit të nevojshëm të caktimit të fondeve, ai do të depozitojë një instrument të cilësuar angazhimi në një formë të pranueshme për Shoqatën (Instrumenti i cilësuar i angazhimit) dhe ai anëtar:

i) merr përsipër të bëjë përpjekjet maksimale për marrjen e aprovimit legjislativ në lidhje me shumën e plotë të nënshkrimit dhe kontributit të tij deri në datat e pagesave të përcaktuara në paragrafin 3 (b) të kësaj rezolute; dhe

ii) bie dakord që me marrjen e këtyre aprovimeve, ai do të njoftojë Shoqatën se ndonjë pjesë e Instrumentit të tij të cilësuar të angazhimit nuk është e cilësuar.

## 3. Pagesa

a) Çdo anëtar nënshkrues do t'i paguajë Shoqatës shumën e nënshkrimit të tij të plotë brenda 31 ditëve pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të angazhimit; me kusht që nëse plotësimi i gjashtëmbëdhjetë nuk do të ketë hyrë në fuqi deri më 15 dhjetor 2011, pagesa mund të shtyhet nga anëtarë për jo më shumë se 31 ditë pas datës së hyrjes në fuqi që përcaktohet në paragrafin 6 (a) të kësaj rezolute;

b) Çdo anëtar kontribues, i cili depoziton një instrument angazhimi që nuk është Instrument i cilësuar i angazhimit, do t'i paguajë Shoqatës shumën e nënshkrimit dhe kontributit të tij në tri këste vjetore të barabarta jo më vonë se 31 ditë pas datës së hyrjes në fuqi ose siç bihet dakord me Shoqatën, 15 janar 2013 dhe 15 janar 2014, me kusht që:

- i) Shoqata dhe çdo anëtar kontribues mund të bjerë dakord për pagesa të mëparshme;
- ii) Nëse rimbushja e gjashtëmbëdhjetë nuk ka hyrë në fuqi deri më 15 dhjetor 2011, pagesa e kështit të parë të tillë mund të shtyhet nga anëtari për jo më shumë se 31 ditë pas datës në të cilën hyn në fuqi rimbushja e gjashtëmbëdhjetë;
- iii) Shoqata mund të bjerë dakord për shtyrjen e çdo kësti ose një pjese të tij, nëse shuma e paguar, së bashku me çdo balancë të papërdorur nga pagesat e mëparshme nga shtetet kontribues përkatës, është të paktën e barabartë me shumën e parashikuar nga Shoqata që kërkohet nga ai anëtar deri në datën e kërkueshme të kështit tjetër për qëllimet e disbursimeve për financimin e dhënë sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë; dhe
- iv) Nëse një anëtar kontribues depoziton një instrument angazhimi të Shoqata pas datës në të cilën bëhet i kërkueshëm kësti i parë i abonimit dhe i kontributit, pagesa e çdo kësti ose e një pjese të tij do t'i bëhet Shoqatës brenda 31 ditëve pas datës së këtij depozitimi.
- c) Nëse një anëtar kontribues ka depozituar një instrument të kualifikuar angazhimi dhe pas miratimit të legjislacionit të pjesëtimit, njofton Shoqatën që kësti, ose një pjesë e tij është i pakualifikuar pas datës kur është i kërkueshëm, pagesa e këtij kësti ose e një pjese të tij do të bëhet brenda 31 ditëve pas datës së këtij njoftimi.

#### 4. Mënyra e pagesës

- a) Pagesat në pajtim me këtë rezolutë do të bëhen, sipas zgjedhjes së anëtarit: i) me para në dorë, sipas kushteve të rëna dakord ndërmjet anëtarit dhe Shoqatës; ose ii) me depozitim të notave ose obligacioneve të ngjashme të emetuara nga qeveria e anëtarit ose depozituesi i caktuar nga ky anëtar, që është e panegociueshme, pa interes dhe e pagueshme në vlerën e tyre nominale me kërkesë në llogari të Shoqatës;
- b) Shoqata arkëton notat ose obligacionet e ngjashme të anëtarëve kontribues me bazë afërsisht proporcionalisht rata ndërmjet donatorëve, në pajtim me grafikun e arkëtimit të përcaktuar në shtojcën II të kësaj rregulloreje ose siç është rënë dakord ndërmjet një anëtarit kontribues dhe shoqatës. Në lidhje me një anëtar kontribues që nuk është në gjendje të përmbushë një ose disa kërkesa arkëtimi, Shoqata mund të bjerë dakord me anëtarin për një grafik të rishikuar arkëtimi që jep të paktën një vlerë të barabartë për shoqatën;
- c) Dispozitat e nenit IV, seksioni 1(a) i neneve do të zbatohet për përdorimin e monedhës së anëtarit abonent të paguar shoqatës në pajtim me këtë rezolutë.

#### 5. Monedha e emërimit dhe pagesës

- a) Anëtarët do të emërtojnë burimet që do të vihen në dispozicion sipas kësaj rezolute në SDR, monedhën e anëtarit nëse është lirisht e konvertueshme, ose me pëlqim të Shoqatës, në një monedhë lirisht të konvertueshme të një anëtarit tjetër, përveç rastit nëse ekonomia e një anëtarit kontribues i është nënshtruar një niveli inflacioni më tepër se dhjetë për qind në vit mesatarisht në periudhën 2007-2009, siç përcaktohet nga Shoqata, nënshkrimi dhe kontributi i tij do të emërtohen në SDR ose në ndonjë monedhë të përdorur për vlerësimin e SDR-së dhe të rënë dakord me Shoqatën;
- b) Anëtarët kontribues do të kryejnë pagesat sipas kësaj rezolute në SDR, një monedhë të përdorur për vlerësimin e SDR-së, ose me pëlqimin e Shoqatës, në një monedhë tjetër lirisht të konvertueshme dhe Shoqata mund të shkëmbejë lirisht shumat e marra të kërkuara për operacionet e saj. Anëtarët nënshkrues do të kryejnë pagesat në monedhën e anëtarit ose në një monedhë lirisht të konvertueshme, me pëlqimin e Shoqatës;
- c) Çdo anëtar do të ruajë në lidhje me monedhën e tij të paguar nga ai sipas kësaj rezolute dhe monedhën e këtij anëtarit që rrjedh si principal, interes ose tarifa të tjera, të njëjtën normë këmbimi që ekzistonte në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rezolute;
- d) Dispozitat e nenit IV, seksioni 2 i neneve në lidhje me ruajtjen e vlerës nuk do të jenë të zbatueshme.

#### 6. Data e hyrjes në fuqi



a) Plotësimi i gjashtëmbëdhjetë do të hyjë në fuqi dhe burimet që do të kontribuohen sipas kësaj rezolutive, do të bëhen të pagueshme për Shoqatën në datën (data e hyrjes në fuqi), kur anëtarët kontribues, nënshkrimet dhe kontributet e të cilëve përbëjnë jo më pak se SDR 10,395 milionë, që kanë depozituar pranë Shoqatës instrumentet e angazhimit, instrumentet e cilësuar të angazhimit ose njoftimet për transferimin e lehtësimit të borxhit (siç përcaktohet në paragrafin 9 (b) të kësaj rezolutive), me kusht që kjo datë të mos jetë më vonë se data 15 dhjetor 2011, ose në atë datë të mëvonshme që mund të caktojnë drejtorët ekzekutivë të shoqatës;

b) Nëse Shoqata konstaton se disponueshmëria e burimeve shtesë sipas kësaj rezolutive mund të jetë e vonuar në mënyrë të pajustificueshme, ajo do të organizojë menjëherë një mbledhje me anëtarët kontribues për rishikimin e situatës dhe për të analizuar hapat që duhet të merren në lidhje me parandalimin e një pezullimi të financimit për përfituesit e mundshëm nga Shoqata.

#### 7. Kontributet paraprake

a) Me qëllim që të mënjanohet ndërprerja e aftësisë së Shoqatës për dhënien e financimit për përfituesit e përshtatshëm në pritje të hyrjes në fuqi të rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë, Shoqata mund të konsiderojë, para datës së hyrjes në fuqi, një të tretën e shumës totale të çdo abonimi dhe kontributin për të cilën është depozituar një instrument angazhimi te Shoqata, ose për të cilën është marrë një njoftim transferimi për lirimin nga borxhi (sipas parashikimit në paragrafin 9 (b) të kësaj rezolutive) nga Shoqata, si një “kontribut paraprak”, përveç kur anëtari kontribues përcakton ndryshe në instrumentin e angazhimit ose njoftimin e transferimit të lirimit nga borxhi.

b) Shoqata specifikon kur duhet t'i paguhen Shoqatës kontributet paraprake në pajtim me nënparagrafin “a”.

c) Termat dhe kushtet që zbatohen për kontributet për rimbushjen e gjashtëmbëdhjetë zbatohen edhe për kontributet paraprake deri në datën e hyrjes në fuqi, nëse këto kontribute konsiderohen të përbëjnë pagesa kundrejt shumës së kërkueshme prej çdo shteti kontribues për abonimin dhe kontributin e tij.

d) Në rastin kur rimbushja e gjashtëmbëdhjetë nuk hyn në fuqi në pajtim me paragrafin 6 (a) të kësaj rezolutive: i) të drejtat e votimit i jepen çdo anëtari për kontributin paraprak sikur të ishte bërë si abonim dhe kontribut sipas kësaj rezolutive; dhe ii) çdo anëtar që nuk jep një kontribut paraprak nuk ka mundësinë të ushtrojë të drejtat e parablerjes sipas nenit III, seksioni I (c) të neneve në lidhje me këtë abonim, sipas specifikimit të shoqatës.

#### 8. Autoriteti i angazhimit

a) Abonimet dhe kontributet bëhen të disponueshme për zbatim nga Shoqata për të financuar përfituesit e përshtatshëm në tri këste vjetore të barabarta: i) kësti i parë bëhet i disponueshëm për Shoqatën për zbatim nga data e hyrjes në fuqi, me kusht që kontributet paraprake të bëhen të disponueshme më parë sipas paragrafit 7 (a) të kësaj rezolutive; ii) kësti i dytë bëhet i disponueshëm nga data 1 korrik 2012; dhe iii) kësti i tretë bëhet i disponueshëm nga data 1 korrik 2013.

b) Çdo pjesë e kualifikuar e abonimit dhe e kontributit të njoftuar sipas një instrumenti të kualifikuar të angazhimit, bëhet e disponueshme për zbatim nga Shoqata për financim, kur Shoqata është njoftuar, në pajtim me paragrafin 2 (b) (ii) të kësaj rezolutive, që këto pjesë janë diskualifikuar.

c) Shoqata mund të marrë përsipër detyrime financiare me përfituesit e përshtatshëm, me kusht që këto detyrime të hyjnë në fuqi dhe të jenë detyruese për shoqatën kur burimet sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë të bëhen të disponueshme për zbatim nga Shoqata.

#### 9. HIPCS dhe kontributet për shlyerjen e borxheve të prapambetura

a) Anëtarët kontribues që kryejnë një nënshkrim dhe kontribut fillestar për të kompensuar Shoqatën për faljen e borxhit sipas Inicativës për lehtësimin e borxhit HIPC ose për të financuar operacionet e shlyerjes së borxheve të prapambetura, do ta bëjnë këtë ose: i) nëpërmjet një nënshkrimi dhe kontributi shtesë për burimet e rregullta të Shoqatës (kontribut shtesë për lehtësimin e borxhit); ose ii) nëpërmjet një kontributi për kreditor specifik në Interes të Shoqatës për Inicativën HIPC të fondit të besimit për lehtësimin e borxhit ose një kontribut për iniciativën e shlyerjes së

borxheve të prapambetura të fondit të besimit për lehtësimin e borxhit (secili quhet “kontribut për transferimin e lehtësimit të borxhit”).

b) Anëtarët kontribues që japin një kontribut për transferimin e lehtësimit të borxhit ose: i) do të lidhin një marrëveshje kontributi me Shoqatën si administratore të fondit të besimit për lehtësimin e borxhit; ose ii) për anëtarët kontribues që aktualisht janë kontribues për fondin e besimit për lehtësimin e borxhit, i dërgojnë Shoqatës një njoftim të kontributit shtesë ose alokimit për iniciativën përkatëse të fondit të besimit për lehtësimin e borxhit (secili quhet “Njoftim për transferimin e lehtësimit të borxhit”). Ky njoftim transferimi për lehtësimin e borxhit do të parashikojë dhënien e një kontributi për iniciativën përkatëse të fondit të besimit për lehtësimin e borxhit në shumat e përcaktuara në kolonat (7) dhe (10) të tabelës 1 të kësaj rezolute, ku secili do të paguhet në tri këste të barabarta vjetore jo më vonë se 31 ditë pas datës së hyrjes në fuqi, 15 janar 2013 dhe 15 janar 2014; me kusht që Shoqata dhe çdo anëtar kontribues mund të bjerë dakord për pagesë paraprake.

c) Kur ndonjë shumë e kontributit të transferimit për lehtësimin e borxhit është paguar për të kompensuar Shoqatën për faljen e borxhit sipas Iniciativës së borxhit HIPC ose për të financuar operacionet mbi shlyerjen e borxheve të prapambetura, kjo shumë e kontributit për transferimin e lehtësimit të borxhit do të trajtohet si nënshkrim dhe kontribut sipas plotësimit të gjashtëmbëdhjetë.

#### 10. Kompensimi për riqarkullimet e mëparshme të principalit

a) Anëtarët kontribues që kryejnë një nënshkrim dhe kontribut shtesë për të financuar riqarkullimet e mëparshme të principalit nga dhënia e grandeve, do ta bëjnë këtë nëpërmjet një nënshkrimi dhe kontributi shtesë për burimet e rregullta të shoqatës (kontribut shtesë për kompensimin e grandit).

11. Autorizimi për grandet, garancitë dhe ndërmjetësimin e riskut. Me anë të këtij instrumenti, Shoqata autorizohet për dhënien e financimit sipas plotësimit të gjashtëmbëdhjetë në formën e grandeve dhe garancive dhe nëpërmjet ndërmjetësimin të produkteve për menaxhimin e riskut.

#### 12. Administrimi i fondeve IDA 15 sipas plotësimit të gjashtëmbëdhjetë

a) Në datën e hyrjes në fuqi, çdo fond, faturë, aktivët dhe pasivët e mbajtur nga Shoqata sipas plotësimit të gjashtëmbëdhjetë, do të administrohen sipas plotësimit të gjashtëmbëdhjetë, duke iu nënshtruar, sipas rastit, kushteve dhe afateve të zbatueshme për plotësimin e pesëmbëdhjetë.

b) Në pajtim me nenin V, seksioni 2 (a) (i) i neneve të marrëveshjes së shoqatës, Shoqata autorizohet të përdorë fondet që përmenden në paragrafin 11(a) më sipër, dhe fondet e përfuara prej tyre si principale, interes ose detyrime të tjera, për të dhënë financim në formën e grandeve dhe garancive sipas termave, kushteve dhe politikave sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë.

13. Caktimi i të drejtave të votës sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë. Të drejtat e votës, të llogaritura mbi këtë bazë të sistemit të tashëm të të drejtave të votës u jepen anëtarëve për abonimet sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë, si më poshtë:

a) Çdo anëtar abonent që ka depozituar te Shoqata një instrument angazhimi do t'i jepen votat e abonimit të specifikuar për çdo anëtar të tillë në tabelën 2 të datës përkatëse të pagesës sipas paragrafit 3(a) të kësaj rezolute. Çdo anëtar abonent do t'i jepen vonat shtesë të anëtarësisë të specifikuar në kolonën c - 3 të tabelës 2 në datën kur këtij anëtar i jepen votat e abonimit;

b) Çdo anëtar abonent që ka depozituar tek Shoqata një instrument angazhimi do t'i jepen një e treta e votave të abonimit të specifikuar për këtë anëtar në tabelën 2 të datës përkatëse të pagesës sipas paragrafit 3 (a) të kësaj rezolute. Çdo anëtar abonent do t'i jepen vonat shtesë të anëtarësisë të specifikuar në kolonën b - 4 të tabelës 2 për abonimin e tij në datën kur këtij anëtar i jepet një e treta e para e votave të abonimit;

c) Çdo anëtar kontribues që ka dhënë një kontribut transferimi lirimi nga borxhi do t'i jepet një pjesë proporcionale e votave të abonimit të specifikuar për këtë anëtar në kolonën b - 3 të tabelës 2 herë pas here dhe të paktën një herë në gjashtë muaj pas pagesës së një shume të



kontributit të transferimit të lirimit nga borxhi për të kompensuar shoqatën për faljen e borxhit, sipas Inicativës së borxhit HIPC ose për të financuar operacionet e shlyerjes së vonesave;

d) Çdo anëtar që ka depozituar te Shoqata një instrument të kualifikuar përkushtimi do t'i jepen vota abonimi të momentin dhe masën e pagesave të bëra në lidhje me abonimin dhe kontributin e tij;

e) Çdo anëtar që depoziton një instrument angazhimi pas një prej këtyre datave do t'i jepen 31 ditë pas datës së depozitimit, votat e abonimit për të cilat ka të drejtë ky anëtar në llogari të kësaj depozite;

f) Nëse një anëtar nuk paguan një shumë të abonimit ose të kontributit kur bëhet e kërkueshme, numri i votave të caktuara herë pas here për këtë anëtar sipas kësaj rezolute në lidhje me rimbushjen e gjashtëmbëdhjetë do të zbriten në raportin e diferencës së këtyre pagesave, por këto vota do të rijepen pasi të bëhet diferenca e pagesave që ka shkaktuar këtë ndryshim.

(Miratuar më 26 prill 2011)

Shtojca 1

**SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM  
SHITESAT E BURIMEVE: PLOTËSIMI I GJASHTËMBËDHJETË  
INSTRUMENTI I ANGAZHIMIT**

Duke iu referuar rezolutës nr. \_\_\_ të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, me titull “Shtesat e burimeve: plotësimi i gjashtëmbëdhjetë”, e cila u miratua më \_\_\_ 2011 (rezoluta).

Me anë të këtij instrumenti, qeveria e \_\_\_\_\_ njofton Shoqatën, sipas paragrafit 2 të rezolutës, se do të bëjë \_\_\_\_\_<sup>5</sup> të autorizuar për të, në përputhje me kushtet e rezolutës, në shumën prej \_\_\_\_\_<sup>6</sup>.

\_\_\_\_\_  
(Data)

\_\_\_\_\_<sup>7</sup>  
(Emri dhe pozicioni)

<sup>5</sup> Kjo formë e instrumentit të angazhimit mund të përdoret për një kontribut të rregullt të një anëtarit kontribues, me çdo kontribut shtesë për lehtësimin e borxhit dhe çdo kontribut shtesë për kompensimin e grandit ose nëninstrumente të veçanta, ose të kombinuara. Anëtarët kontribuues plotësojnë fjalët “nënshkrim dhe kontribut” për të dyja kontributet e rregullta dhe kontributet shtesë për lehtësimin e borxhit, dhe anëtarët nënshkruan plotësojnë vetëm fjalën “nënshkrim”.

<sup>6</sup> Sipas paragrafit 5 (a) të rezolutës së plotësimit të gjashtëmbëdhjetë, anëtarëve u kërkohet të emërtojnë nënshkrimin dhe kontributin e tyre ose vetëm nënshkrimin, sipas rastit, në SDR, në monedhën e anëtarit, nëse është lirish e konvertueshme, ose me pëlqimin e shoqatës, në një monedhë lirish të konvertueshme të anëtarit tjetër. Pagesa do të kryhet siç parashikohet në paragrafin 5 (b) të rezolutës.

<sup>7</sup> Instrumenti duhet të nënshkruhet në emër të qeverisë nga një përfaqësues i autorizuar sipas rregullave.

**VENDIM**  
**Nr. 776, datë 15.11.2012**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 670, DATË 3.10.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR LEJIMIN E EKSPozIMIT, NË ROMË, ITALI, TË DISA  
OBJEKTEVE TË RRALLA ME VLERA UNIKE, NË KUADËR TË REALIZIMIT TË  
EKSPozITËS “THESARE TË KULTURËS SHQIPTARE”, NGA DATA 20 NËNTOR 2012  
DERI MË 6 JANAR 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Risisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në lidhjen me nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi nr. 670, datë 3.10.2012 të Këshillit të Ministrave, të shtohet objekti, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr. 1

Autori: Onufri “Gjon Pagëzori”, nr. inv. 23, shek XVI, përmasat 110 x 72.5 x 4.5

**VENDIM**  
**Nr. 777, datë 16.11.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 693, DATË 10.10.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERITARE, QË LËSHOHET NË  
FAVOR TË RAIFFEISEN BANK SHA, ALBANIA DHE INTESA SANPAOLO SHA,  
ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATAVE PËRKATËSE NDËRMJET KËTYRE  
BANKAVE DHE KESH SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 693, datë 10.10.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën ekuivalente, në lekë, të shumës 50 (pesëdhjetë) milionë euro.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 779, datë 14.11.2012**

**PËR LEJIMIN E INSPEKTORATIT QENDROR, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE LIDHJEN E KONTRATËS, ME OBJEKT “RIKONSTRUKSION I AMBIENTEVE NË PËRDORIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Inspektoratit Qendror, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratës, brenda datës 20.12.2012, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2012, për objektin “Rikonstruksion i ambienteve të dhëna në përdorim për Inspektoratin Qendror”, me fond limit 7 485 190 (shtatë milionë e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Inspektorati Qendror dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 793, datë 14.11.2012**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si autoritet kontraktor, të përfundojë kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2012, në zërin “Shpenzime 8324



operative”, për objektin “Botimi i revistës “Auditimi publik” dhe botime të tjera”, me fond limit 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, pa TVSH, deri në datën 24 dhjetor 2012. Brenda kësaj periudhe të përfshihet publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 794, datë 14.11.2012**

**PËR LEJIMIN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI AUTORITET  
KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Kuvendit të Shqipërisë, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit, si dhe për të lidhur kontratat përkatëse, për investimet sipas aneksit 1, deri më 24 dhjetor 2012. Brenda kësaj periudhe të përfshihen edhe publikimi i fituesit dhe i njoftimit të kontratës së lidhur në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**ANEKSI 1**

- Blerje pajisjesh dhe shërbime konfirmuese për krijimin e qendrës së të dhënave e E-Parlament, ndarë në lote, me fonde limit 48,708,670 lekë pa TVSH, në proces.

- Loti I - blerje kompjuterë, pajisje fundore (*desktop, lap top, tablet PC, USB smart card reader dhe smart card*), me fond limit 21,914,272 lekë pa TVSH, është në procesin e shpalljes së fituesit.

- Loti II - blerje serverë, shasi dhe rack me fond limit 13,390,515 lekë pa TVSH, është pezulluar nga Komisioni i Prokurimit Publik për shkak të ushtrimit të së drejtës së ankimimit.

- Loti III - Blerje pajisjesh për ruajtjen e të dhënave të rrjet (*San Storage*), me fond limit 3,313,051 lekë pa TVSH, është shpallur fituesi, por nuk është lidhur ende kontrata.

- Loti IV - Blerje pajisjesh për ruajtjen e të dhënave me kaseta (*Tape Library*), me fond limit 1,483,103 lekë pa TVSH, është shpallur fituesi por nuk është lidhur ende kontrata.

- Loti V - Furnizim vendosje pajisje rrjeti me fond limit 8,607,725 lekë pa TVSH, është pezulluar nga KPP për shkak të ushtrimit të së drejtës së ankimimit.



**VENDIM**  
**Nr. 795, datë 14.11.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E FINANCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitit 2012, në programin “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, në kategorinë e shpenzimeve korente, t’i shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 798, datë 14.11.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 713, DATË 16.10.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË TURIZMIT,  
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË  
FESTIVALIT TË 13-TË TË FILMIT SHQIPTAR, FESTIVALIT MBARËKOMBËTAR TË  
DRAMËS SHQIPE DHE REALIZMIN E DRAMËS FITUESE, SHPALLUR NË  
KONKURSIN ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

- Në vendimin nr. 713, datë 16.10.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “...Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve...” të shtohen “...dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë...”.
  2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
    - “1. Institucioneve të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:
      - a) Ministrisë së Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve t’i shtohet fondi në shumën 10 371 200 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve 8326

të Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizmin e dramës fituese, shpallur në konkursin me rastin e 100 - Vjetorit të Pavarësisë.

b) Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në artikullin 604, “Projekte”, t’i shtohet fondi 5 475 000 (pesë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar.”.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 799, datë 14.11.2012**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR  
DISA INSTITUCIONE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI  
AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e disa institucioneve në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë të përfundojnë, brenda datës 15.12.2012, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2012, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen dhe lidhja e kontratave përkatëse e njoftimi i këtyre kontratave të nënshkuara në Agjencinë e Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**ANEKSI 1**

**1. Spitali Mallakastër**

“Rikonstruksioni i ambienteve të RO’ spitali Mallakastër” me vlerë limit 3.750.000 lekë pa TVSH.

Për këtë investim është realizuar procedura e prokurimit dhe është dërguar në APP shpallja e njoftimit të fituesit.

“Blerje solari për ngrohje, spitali Mallakastër” me fond limit 1.000.000 lekë pa TVSH.



Kjo procedurë është anuluar nga ana e Ministrisë së Brendshme, për shkak të mungesës së konkurrencës. Realizimi i kësaj procedure do të sigurojë lëndën e nevojshme për ngrohjen e ambienteve të spitalit si për pacientët, ashtu dhe për stafin.

## 2. Spitali Peqin

“Përshtatje për ambientin e RO’ spitali Peqin” me fond limit 3.750.000 lekë pa TVSH.

“Përshtatje e kuzhinës dhe e magazinës, si rrjedhojë e spostimit të këtyre ambienteve, për vënien në dispozicion të atyre ekzistuese për ambientet e RO’ spitali Peqin” me fond limit 2.500.000 lekë. Për të dyja investimet e lartpërmendura të spitalit Peqin, janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit dhe është faza e shpalljes së fituesve në buletin e APP-së.

## 3. Spitali Korçë

“F.V pajisje mjekësore për dializën e spitalit Korçë” me fond limit 26.500.000 lekë pa TVSH.

Procedura e prokurimit hapet në datën 5.11.2012, për rrjedhojë, nuk arrihet lidhja e kontratës brenda 31.10.2012. Fondi është alokuar nga Ministria e Financave me shkresën me nr. 13872/1, datë 12.9.2012. Lejimi i vazhdimit të kësaj procedure do të bëjë të mundur hapjen e shërbimit të dializës në spitalin e Korçës, ambientet e të cilit tashmë janë gati.

“Shërbim i rojeve private të spitalit Korçë” me fond limit 4.800.000 lekë pa TVSH.

Në datën 17.10.2012 ka dalë vendimi i KPP-së, i cili kërkon rivlerësimin e ofertave nga KVO-ja. Lejimi i vazhdimit të kësaj procedure nga ana juaj, do të bëjë të mundur njoftimin e fituesit dhe lidhjen e kontratës për pjesën e mbetur të vitit.

## 4. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë

“F.V pajisje mjekësore për kirurgjinë vaskulare në QSUT “Nënë Tereza”” me fond limit 5.000.000 lekë pa TVSH.

Investimi është në proces tenderimi

“Blerje djegëse, gazoil për ngrohje në QSUT” me fond limit 31.017.000 lekë pa TVSH.

Nisur nga nevojat e të gjitha shërbimeve të QSUT-së, del e domosdoshme realizimi i një procedure tjetër për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje.

“Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtjeje e rrjetit rrugor për QSUT-në” me fond limit 1.945.668 lekë pa TVSH.

Procedura e lartpërmendura është anuluar nga KPP-ja dhe do të rishpallet edhe njëherë.

## 5. S.U.S.M “Shfaqet Ndroqi” Tiranë

“Blerje lënde djegëse për ngrohjen (pellet), S.U.S.M “Shfaqet Ndroqi”” me fond limit 8.324.299 pa TVSH.

Vlerësimi i kësaj procedure është mbyllur në sistemin elektronik nga KVO-ja në datën 30.8.2012. Lejimi i vazhdimit të kësaj procedure nga ana juaj, do të bëjë të mundur njoftimin e fituesit nga ana e autoritetit kontraktor

## 6. Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopterë Tiranë

“Blerja vajguri JET A-1 për Nj.T.M. Helikopterëve Tiranë” me fondin limit 2.250.000 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është mjaft e rëndësishme për t’u realizuar, pasi karburanti i planifikuar për vitin 2012 ishte i pamjaftueshëm, për shkak të emergjencave civile të periudhës janar-shkurt të vitit 2012, shoqëruar me harxhim të karburantit.

## 7. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë

“Ruajtja me roje private e ambienteve të Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë”, me fond limit 5.642.700 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është në fazën e pritjes së vendimit nga KPP-ja. Lejimi i vazhdimit të kësaj procedure nga ana juaj. Do të bëjë të mundur njoftimin e fituesit dhe lidhjen e kontratës për pjesën e mbetur të vitit.

**UDHËZIM**  
**Nr. 24, datë 2.11.2012**

**PËR NJË SHITESË E NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 8.1.2009 “PËR  
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE  
TELEVIZIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar

**UDHËZOJNË:**

Në udhëzimin nr. 1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2.2 germa “c”, pas togfjalëshit “furnizimi i antenave të telefonisë celulare”, shtohet togfjalëshi “ndriçimi publik i rrugëve”.

2. Shtojca 1 zëvendësohet me “shtojcën 1”, bashkëlidhur këtij udhëzimi, si pjesë integrale e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**

**Ridvan Bode**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I  
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

**Petri Beci**

**SHTOJCA NR. 1**  
**INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT MBI KATEGORITË E PËRJASHTUARA**

<b>Emërtimi</b>	<b>Përshkrimi i kategorive</b>	<b>Institucionet përgjegjëse për dhëniën e informacionit mbi kategoritë e përjashtuara</b>
Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashist të popullit shqiptar”, të ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”.	Të verbrit/paraplegjikë/tetraplegjikë	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
	Veteranë lufte	Ministria e Mbrojtjes
	Invalid pune	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë në bazë të parimit të reciprocitetit	Ambasadat	Ministria e Punëve të Jashtme
Bashkësitë fetare:	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë	Komiteti Shtetëror për Kulturë



Faturimi i energjisë elektrike për aktivitete të tilla si: miniera, ujësjellës, puset e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare, ndriçimi publik i rrugëve dhe garazhet e mjeteve lëvizëse	Miniera	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Ujësjellës	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	Puse nafte	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Antena celulari	AKEP (Agjencia e Komunikimeve Elektronike)
	Ndriçimi publik i rrugëve	Bashkitë
	Garazhet e mjeteve lëvizëse	Sipas përcaktimeve të bëra në faturën e energjisë

### URDHËR

Nr. 244/1, datë 15.11.2012

#### PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.199 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

#### URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për Ministrinë e Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Isuf Çelaj.
  2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datën 31 dhjetor 2012.
  3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
  4. Urdhri nr. 244, datë 23.7.2012 “Për delegim kompetencash”, revokohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM  
Flamur Noka

### VENDIM

Nr. 151, datë 12.11.2012

#### PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të nenit 64 pika 1 germa “dh” dhe “gj” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe neneve 5 dhe 6 e në vazhdim të rregullores “Për vendosjen e gjobave dhe kushteve të lehtësimit prej tyre”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 101, datë 19.7.2012, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

“CEZ Shpërndarje” ka kryer shkelje të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, neni 2 pika 1, mbi furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve tariforë.

Shoqëria “CEZ Shpërndarje” ka kryer shkelje të pikës 3.1 të kushteve të licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pikës 3.1 të licencës së furnizimit publik me pakicë.

Shkaqet e kryerjes së kundërvajtjes konsiderohen të mesme, nisur nga fakti i mungesës së modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt, me qëllim parandalimin e shkeljeve, si dhe mungesë personeli në mirëmbajtjen dhe kontrollin e linjave elektrike, kryesisht kjo në zonat rurale.

I licencuari është dënuar më parë për kundërvajtje (me anë të vendimit nr. 90, datë 15.11.2010 dhe vendimit nr. 128, datë 11.9.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s), por jo për të njëjtën shkelje.

Pasojat e ardhura nga veprimet e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. do të konsiderohen mesatare. Kjo duke parë numrin e klientëve të përfshirë dhe dëmin e shkaktuar konsumatorëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.
2. Vlera fillestare e gjobës është në masën 1.11 % të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

#### VENDIM Nr. 152, datë 12.11.2012

### **PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 68, DATË 23.6.2008**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii”, 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

#### VENDOSI:

1. Në kapitullit X të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të shtohet pika 2, me përmbajtjen si



vijon: “Çdo pjesëtar i tregut, që ka përgjegjësi për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, kur argumenton që rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike e konsumatorëve fundorë, mund të bëjë kërkesë në ERE, që Bordi i Komisionerëve të alokojë me të drejta të siguruara kapacitetet e lira të muajit pasardhës, pa cenuar të drejtat e rezervuara në ankandet vjetore.

Bordi i Komisionerëve do të vendosë rast pas rasti, për periudha jo më të gjata se një muaj, mbi bazë të argumenteve të paraqitura në kërkesë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a., “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe shoqatën AEES, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 153, datë 12.11.2012**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 13, SERIA PV03K, TË SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BARMASH”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 20, DATË 19.12.2003, MODIFIKUAR ME VENDIMIN NR. 79, DATË 23.10.2009**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9, 13 pika 1 germa “a” dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3 dhe pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikave 2.3 dhe 2.4 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Është dhënë informacioni me shkrim, ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15 pika 4 germa “a”);

- Është paraqitur vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës (neni 15 pika 4 germa “b”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë modifikimin e licencës me nr. 13, seria PV03K, të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Barmash”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, modifikuar me vendimin nr. 79, datë 23.10.2009.



2. Fuqia e instaluar e hec “Barmash”, nga 630 KW të bëhet 830 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 154, datë 12.11.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK  
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”; 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, sipas procedurave standarde të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 155, datë 12.11.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK  
NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31; 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”; 5 pika 1 germa “f”; 8; 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germet “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 156, datë 12.11.2012**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SHPK, PËR  
NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe pikës 5.3 të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Shoqëria “Aurora konstruksion” sh.p.k., ka transferuar të gjitha kuotat e saj prej 50% që posedon si ortakë të shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k. subjektit “Anna Energia” sh.p.k., duke dhënë dorëheqjen në këtë mënyrë nga posedimi i kuotave të zotëruara të shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k.

- Shoqëria “Roen Company” sh.p.k., ka transferuar 1% të kuotave nga 50% që zotëron të shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k. shoqërisë “Anna Energia” sh.p.k.

- Në këto kushte ortakët aktualë të shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k. janë: subjekti “Anna Energia” sh.p.k., e cila posedon 51% të kuotave të kapitalit themeltar dhe subjekti “Roen Company” sh.p.k., e cila posedon 49% të kuotave të kapitalit themeltar.

- Subjekti “Anna Energia” sh.p.k., nga transaksionet e kryera rezulton si ortaku mazhoritar që kontrollon interesat e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**



**VENDIM**  
**Nr. 157, datë 15.11.2012**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SHA PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN DHJETOR 2012**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X pika 2 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.11.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. nr. 5024 prot. datë 12.11.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton se:

- Nivelet e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, si dhe basenet e tjera të heceve që operojnë në vendin tonë, nuk janë në nivelet optimale për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm për muajt në vijim. Nga raportimet periodike të bëra pranë ERE-s, rezulton se niveli i hidrocentralit të Fierzës është 269 metra.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 3.10.2012 lejon KESH sh.a. që të bëjë importet e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

- Prodhimi vendas i energjisë elektrike nuk plotëson kërkesat për energji elektrike të konsumatorëve tariforë.

- Në rekomandimin e datës 19.7.2012, Sekretariati i Vjenës, me qëllim që të sigurohet furnizimi pa ndërprerje i konsumatorëve tariforë ka konsideruar të mundshëm alokimin e kapaciteteve subjektit mbartës të detyrimit për sigurimin e energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, jashtë ankandeve vjetore/mujore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë shoqërisë KESH sh.a. kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin dhjetor 2012, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë.

2. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara, në bazë të pagesës së vlerës së ankandit vjetor, furnizuesve të kualifikuar kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin dhjetor 2012, në drejtim importi, në sasinë që i korrespondon proporcionalisht kontratave që kanë për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të kualifikuar dhe që nuk mbulohen nga kapacitetet e alokuara në ankandin vjetor furnizuesve të kualifikuar.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 158, datë 16.11.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 8, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR DHE PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për heqjen e licencave”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, licencës “Për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, miratuar me vendimet nr. 108 dhe nr. 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; kontratës së furnizimit me energji elektrike me KESH sh.a. dhe “CEZ shpërndarje”; marrëveshjes së transmetimit mes OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2012, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike për heqjen e licencës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për heqje të licencave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. “CEZ Shpërndarje” ka të drejtën për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në bazë të nenit 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 8 të “Rregullores së heqjes së licencës”.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.11.2012  
Doli nga shtypi më 27.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë